



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2021:254448

Datë: 02.12.2024

Numri i dokumentit: 06531787

C.nr.2691/21

GJYKATA THEMELORE NË PEJË-Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtarja Afërdita Mulhaxha, në çështjen juridiko-civile të paditësit H.P., nga fshati N., Komuna e P., të cilin e përfaqëson i autorizuari Burhan Shabanaj, avokat në Pejë, kundër të paditurës Kompania KRU „H.....” SH.A., me seli në Pejë, të cilën e përfaqëson i autorizuari R.K., nga Peja, për shkak të kompenzimit të të ardhurave personale. vlera e kontestit: 12.179,58€, pas shqyrtimit kryesor të mbajtur me dt.20.11.2024, në praninë e paditësit dhe të autorizuarve të palëve ndërgjyqëse, me dt.26.11.2024, merr këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET në tërësi kërkesëpadia e paditësit H.P., nga fshati N., Komuna e P., më të cilën ka kërkuar që:

„DETYROHET Kompania Rajonale e Ujësjetës KRU „Hidrodrini” SH.A., me seli në Pejë, që paditësit H.P., në emër të ardhurave personale-diferencës në pagë në raport me kolegun e të njëjtës pozitë të punës, t’ia kompensoj të ardhurat mujore-diferencën në pagë, për periudhën kohore nga dt.09.03.2017, e deri më dt.31.03.2024, në pagën bruto, në shumë të përgjithshme prej 12.788,58€ (dymbëdhjetë mijë e shtatëqind e tetëdhjetë euro e pesëdhjetë e tetë cent) e të gjitha këto me kamatë prej 8% të llogaritur nga dita e ushtrimit të padisë e deri në pagesën definitive, si dhe palës paditëse t’ia kompensojë të gjitha shpenzime procedurale në shumë prej 1.251€, e të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi e nën kërcënim të përmbartimit të detyrueshëm.” , SI E PA BAZUAR

A r s y e t i m

Me padi initiale të ushtruar më dt.12.11.2021, në cilësinë e paditësit, fillimisht kanë qenë H.P. dhe S.Rr. ndërsa në cilësinë e paditurës ka qenë Kompania Rajonale e Ujësjetës KRU „Hidrodrini” SH.A., me seli në Pejë, me bazë juridike kompensim i pagës shtesë-diferenca në pagë.

Në shqyrtimin e dt.01.11.2024, i autorizuari i paditësit ka ndryshuar padinë në kuptimin subjektiv në anën e paditësit, ashtu që ka bërë tërheqjen e paditëses S. Rr., ashtu që në cilësinë e paditësit ka mbetur vetëm H. P.

Paditësi me padi initiale, të rregulluar dhe precizimin e saj, të bërë më dt.02.07.2024, gjatë shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare, e nëpërmes të autorizuarit të tij, ka parashtruar se është punëtor i të paditurës, dhe me dt.09.03.2017 dhe dt.13.03.2017, ka bërë kërkesë tek e paditura, të cilën e ka përsëritur edhe me dt.20.07.2021, me arsyetim se për punën e njëjtë nuk paguhet njëjtë, se e paditura ka marr vendim dhe i është ngritur paga për 20€...dhe me kontratën e përmirësuar me nr.122 të dt.31.03.2021, ceket me profesion Bachelor i Artëve në sistemin e informacionit dhe sistemohet në vendin tjetër të punës-Gjeodet i GIS, dhe obligohet

që të filloj punën nga dt.01.01.2021 deri me dt.31.12.2023 (me parë në kontratë e kishte të shënuar „me shkollë të mesme”).

Ka cekur se pas ankesës ë Inspektoratin e Punës ka pranuar vendimin nga ku janë gjetur shkelje ligjore, sipas Ligjit të Punës, të argumentuara nga ky Inspektorat.

Gjatë shqyrtimit kryesor i autorizuari i paditësit ka mbetur pranë padisë dhe precizimit të saj, që paditësit t’i paguhet diferenca në pagë, në raport me kolegun e tij në pozitë të njëjtë të punës, dhe atë për periudhën kohore nga dt.09.03.2017 e deri me dt.31.03.2024, në pagën bruto në shumë të përgjithshme prej 12.788,58€, me kamatë ligjore, nga dita e ushtrimit të padisë...

Në fjalën përfundimtare, ka ritheksuar se mbetet në tërësi pranë parashtrimeve dhe kërkesëpadisë së precizuar me arsyetim, se pas administrimit të provave materiale dhe deklarimit rreth fakteve jo kontestuese, është vërtetuar plotësisht baza juridike e kërkesëpadisë dhe lartësia e saj, ashtu që kërkesëpadia bazën juridike e mbështet në nenin 23 par. 23 i Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut, me të cilën përcaktohet se „gjithkush pa kurrfarë diskriminimi ka të drejtë që për punë të njëjtë të marr pagë të njëjtë, e Deklarata e cekur në kuptim të nenit 22 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, ka supremaci mbi çdo dispozitë dhe akt në vendin tonë, dhe zbatohet drejtpërdrejtë në sistemin tonë të brendshëm.

Se diskriminimin në pagë e ndalon edhe neni 5 par.1 i Ligjit të Punës, përmbledhja nga praktika gjyqësore e Gjykatës Supreme të Kosovës, në çështjen civile...Ka theksuar se lartësia e kërkesëpadisë, provohet me ekspertizën financiare.

Shpenzimet procedurale i ka kërkuar dhe atë: për taksë gjyqësore shumë prej 21€, për 4 seanca të mbajtura, një seancë 270€ e në tërësi shumë prej 1080€, në emër të shpërblimit për ekspert shumë prej 150€, e në shumë të përgjithshme prej 1.251€, mbështetur në tarifën e OAK-së.

E paditura në përgjigje në padi, të bërë me shkrim me dt.30.10.2023, dhe gjatë shqyrtimit kryesor ka theksuar se E kundërshton padinë dhe kërkesën e saj si të pabazuar, dhe të pavërtetuar, ngase faktet dhe provat ku mbështetet padia, janë të pa mbështetura në ligj, dhe se me asnjë provë, paditësi nuk e ka dëshmuar një gjë të tillë.

Ka potencuar, se edhe Inspektorati i Punës, me vendimin e tij, ka konstatuar se paditësi për pretendimet e tij, nuk ka prezantuar prova, se Inspektorati i Punës, nuk posedon dëshmi për t’u vërtetuar se ndonjë i punësuar në Kompaninë e të paditurës, për punën e vlerës së njëjtë të paguhet apo të kompensohet ndryshe. Se me aktvendimin e cekur, e paditura është gjobitur në mungesë të rregullores për nivelizimin e pagave, andaj edhe pretendimi i paditësit nuk qëndron, ka propozuar refuzimin e kërkesëpadisë...

Gjatë shqyrtimit kryesor ka mbetur pranë përgjegjës në padi, se ka qenë kundër propozimit për kryerjen e ekspertizës financiare.

I aut. i të paditurës në fjalën e tij përfundimtare, ka ritheksuar se mbetet në tërësi pranë përgjigjes në padi, dhe çështjen e paditësit e konsideron si të pabazuar, për arsye të kualifikimeve arsimore të ndryshme të paditësit dhe z.M.M.

Konsiderojnë se kërkesëpadia nuk është në përputhje me historikun e punës dhe pagave që ishin, se paditësi, ka kryer punën e gjeodetit, përderisa M. ka kryer punën e inxhinierit për ujësjellës, andaj ka propozuar që gjykata t’u refuzoj padinë si të pabazuar. Shpenzimet procedurale të kërkuara nga pala paditëse ka propozuar që të refuzohen në tërësi si të pabazuara.

Gjykata në këtë çështje kontestimore me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike e me propozimin e palëve ka zhvilluar procedurën e provave ku si provë u administrua: Vendimi i Inspektoratit të Punës i dt.02.11.2021; Aktvendimi për sistemimin e të punësuarit H.P. i dt.05.09.2018, kërkesa për ngritje të pagës e dt.13.03.2017 dhe dt.09.03.2017; kërkesa për nivelizim të pagave, *vendimi për punëtorin S.Rr. i dt.04.07.2003*; Kontrata e Punës për paditësin e dt.31.03.2021, dhe e dt.03.01.2020; ekspertiza e ekspertit financiar Aulon Haxhijakupi, e dt.12.06.2024, deklarimet e të autorizuarve të palëve ndërgjyqëse si dhe të gjitha shkresat tjera që gjenden në lëndë.

Pasi që gjykata bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç, dhe në lidhshmëri me njëra tjetrën, e duke u mbështetur në dispozitat nga neni 8, të Ligjit për Procedurën Kontestimore, arriti në përfundimin se në këtë çështje juridike-civile duhet vendosur si në dispozitiv, të këtij aktgjykimi.

Në mes të palëve ndërgjyqëse është bërë jo kontestues fakti:

- se paditësi ka 21 vite që punon tek e paditura, në pozitën e gjeodetit,
- se kolegu M.M., tek e paditura është i punësuar si Inxhinier Hidroteknik, mbi 10 vite,
- se paditësi dhe kolegu i tij M.M., nuk i kanë marr pagat e njëjta asnjëherë dhe nuk i marrin as sot,
- se pagat që i ka marr për bazë ekspertit financiar Aulon Haxhijakupi, në ekspertizën e tij, të punuar me dt.12.06.2024, nuk janë kontestuese në mes të palëve, pasi që të dyja palët e pranojnë se ekspertit nga e paditura i ka siguruar kontratat e punës, për kolegun M., dhe nuk i kontestojnë,
- se ekziston diferenca në pagë, në mes tyre, dhe nuk e kanë kontestuar ekspertizën financiare të ekspertit Aulon Haxhijakupi.

Është vërtetuar se paditësi, të paditurës i ka dërguar shkresa për nivelizimin e pagave para se të ushtroi padinë initiale, por nuk ka marr përgjigje pozitive...

Inspektorati i Punës lidhur me kërkesën e paditësit ka marr vendim, me dt.02.11.2021, me të cilin vendim të paditurës i është shqiptuar gjoba, për shkak të mungesës së Aktit të Brendshëm të Punëdhënësit, me të cilën rregullohen pagat e të punësuarve...mirëpo, Inspektorati në mungesë të provave...nuk ka vendos për kërkesën e palës paditëse.

Kjo Gjykatë, nuk i morri parasysh pretendimet e paditësit Halil, të cekura në padi, dhe sqarimet që janë dhënë më vonë, se për punë të njëjtë me kolegun, konkretisht M.M., nuk marrin pagë të njëjtë, pasi që ky fakt nuk u argumentua me prova, që do t'i mbështetnin thëniet e paditësit se ka pas ndonjë diskriminim në mes të paditësit dhe kolegës së tij, të cilin e ka marr për krahasim.

Qëndron fakti se paditësi H., ka lidhur kontratën e punës me të paditurën, të njëjten e ka nënshkruar, dhe me nënshkrimin e saj i ka pranuar të gjitha të drejtat dhe detyrimet, që rrjedhin nga kjo kontratë e punës (*paditësi ka nënshkruar disa here kontratën e punës*) dhe këtë veprim kuptohet se paditësi i ka pas të gjitha të drejtat, që kontratën me kushtet që i janë ofruar atij, mos ta nënshkruaj, andaj, kjo gjykatë gjenë se në këtë pikë, paditësi nuk ka arritur që ta siguroj ndonjë provë, se para nënshkrimit, gjatë nënshkrimit të kontratës, ka pasur ndonjë diskriminim, e nëse ka pasur, paditësi ka dështuar që të paraqesë prova, që do të vërtetetonin faktin se i njëjti ka qenë i detyruar të nënshkruaj kontratën e punës, (*neni 7 pika 1 të LPK-së*)

Pasi që gjykata beri vlerësimin e secilës prove veç e veç, e në lidhshmëri me njëra tjetrën, çmuarjen me kujdes dhe ndërgjegje, e duke u mbështetur në dispozitat e nenit 8 të LPK-se, erdhe në përfundim se kërkesëpadija e paditësit është e pa bazuar dhe ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Kjo Gjykatë, përmes padisë së ushtuar dhe deklarimeve të autorizuarit të paditësit gjatë shqyrtimit kryesor, ka vërtetuar thëniet se paditësi H., ka pohuar faktin se ka 21 vite i punësuar tek e paditura, se për këtë punësim ka nënshkruar kontratën e punës (*sipas radhës që gjenden në shkresa të lëndës*).

Gjykata gjen së nuk është argumentuar nga pala paditësi, se me rastin e nënshkrimit të këtyre kontratave të punës, ka pasur presion apo detyrim për t'i pranuar kushtet e kontratës, e që vërteton faktin se këto kontrata të punës janë nënshkruar pa presion dhe me vullnet të lirë...

Kjo gjykatë, pretendimin e palës paditëse, se paditësi nuk ka nivelizim të pagës me kolegun e tij M., e konsideron si të pabazuar, dhe të pa argumentuar me prova.

Qëndron fakti se paditësi dhe kolegu i tij M. janë të punësuar tek e paditura, kanë profesione të ndryshme, dhe kontratat e punës i kanë nënshkruar për vende të ndryshme të punës...dhe që të dy i kanë pas parasysh të drejtat dhe detyrimet që vinë nga kontrata e punës.

Kjo gjykatë përveç të tjerash ka gjetur se në kontratën e punës të nënshkruar nga paditësi H., nuk është i paraparë (*nuk është nënshkruar nga paditësi*) nivelizimi i pagës së tij me pagën e kolegut M..

Pasi që punëdhënësi dhe i punësuar i me rastin e nënshkrimit të kontratës së punës (*që është objekt i shqyrtimit*), i kanë pranuar të drejtat dhe përgjegjësitë e caktuara me ligj, dhe me këtë kontratë të punës.

Andaj, kjo gjykatë konsideron se kërkesëpadia e paditësit me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura t'ia kompensoj shumën prej 12.788,58€, në emër të ardhurave personale-diferencës në pagë në raport me kolegun e të njëjtës pozitë të punës... është e pabazuar, pasi që nuk ka bazë ligjore

Gjykata me rastin e vendosjes i mori për bazë edhe pretendimet e palës paditëse mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe për arsye se me provat e administruara dhe shkresat e lëndës është argumentuar e kundërta për çka gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Për shpenzimet procedurale gjykata vendosi në kuptim të nenit 463 par 1. të LPK-së, pasi që nga pala e paditur nuk pati kërkesë të specifikuar të shpenzimeve procedurale.

Nga arsyet e cekura si më lartë gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

NGA GJYKATA THEMELORE PEJË, C.nr.2691/21, me dt.26.11.2024.

Gj y q t a r j a
Afërdita Mulhaxha

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditëve, nga dita e pranimit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.